

## Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.31 Regj. Themeltar, Datë 09.06.2023 Regjistrimi, me:

**Ankues:** Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

**Ankues:** Person i tretë, kandidati për kryetar bashkie, Bashkia Rrogozhinë, z. Shkëlqim Hoxha.

**Kundër:** Vendimit nr.174, datë 06.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, KQZ.

Më datë **12.06.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Esmeralda Xhili (Relatore);**
- 2. Blerona Hasa (Anëtare);**
- 3. Emona Muçi (Anëtare);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Marsela Dervishi (Anëtare).**

Me Urdhër datë 13.06.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **15.06.2023, ora 15:00**, për zhvillimin e seancës gjyqësore. Relatori i çështjes ka disponuar Vendimin datë 13.06.2023 “Për plotësimin e të metave të kërkesëpadisë”.

Lidhur me ambientin e zhvillimit të seancës gjyqësore, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor caktoi **Gjykatën Administrative të Apelit, në adresën Rr.“Ismail Qemali”, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë**, në kushtet kur prej njoftimeve të datave 12.06.2023 dhe 13.06.2023, në grupin e gazetarëve në aplikacionin ËhatsApp, nuk pati asnjë konfirmim për pjesëmarrje në seancë, çka do të diktonte zhvillimin e seancës në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Tiranë, më 14.06.2023.**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**